STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 11 nëntor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE SHERBIMI I RI I MTA-SE ZEVENDESON PJESEN E SHKATERRUAR TE LINJES SE TRAMVAJIT "A"

Shërbimi "A" është rivendosur në Stacionin Howard Beach

Shërbimi me autobus do të zëvendësojë një pjesë të linjës "A" të goditur nga stuhia

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Autoriteti i Transportit Metropolitan (MTA) do të rifillojë shërbimin në linjën e tramvajit A për në Howard Beach dhe do të fillojë një shërbim me autobus për në Mott Avenue në Far Rockaway, duke rivendosur shërbimin për mijëra banorë të Gadishullit Rokauej që humbën mundësinë e përdorimit të shërbimit të tranzitit pas Uraganit Sendi (Sandy).

"Njerëzit e Gadishullit Rokauej u goditën veçanërisht rëndë nga kjo stuhi dhe rivendosja e shërbimit të transportit për ta dhe për Howard Beach është një përparësi për administratën time," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Ky kombinim i tramvajit dhe shërbimit me autobus do t'u sigurojë ndihmën e menjëhershme të shërbimit të tranzitit ndërsa rindërtohet i gjithë sistemi."

Shërbimi në linjën A për në Howard Beach dhe shërbimi me autobus që atje për në Mott Avenue në Far Rockaway do të fillojë të dielën, më 11 nëntor. Një tren normalisht shkon në Mott Avenue në Far Rockaway si dhe në Lefferts Boulevard, por tashmë shkon vetëm në Lefferts. Pasi të jetë rivendosur shërbimi për në Howard Beach, shërbimi edhe njëherë do të ndahet dhe gjysma do të shkojë në Howard Beach.

Shërbimi me autobus do të mbetet në fuqi derisa të zëvendësohet North Channel Bridge dhe infrastruktura e tramvajit nëpërmjet Broad Channel të dëmtuara rëndë. Ura ishe nën ujë gjatë stuhisë dhe disa pjesë të shinave i mori uji krejtësisht. Fotografi të dëmit janë të disponueshme në faqen e MTA-së në Flickr në
http://www.flickr.com/photos/mtaphotos/sets/72157631921471055/

"Dëmi në linjën A në Xhamejka Bei është absolutisht i pashembullt dhe po kështu është reagimi i MT-së," tha Kryetari dhe CEO i MTA-së Jozef J. Lota (Joseph J. Lhota). "Rivendosja e të gjithë trenit A do të kërkojë disa muaj, por MTA është e përkushtuar që t'a bëjë atë dhe të sigurojë alternativa për klientët tanë gjatë kësaj kohe."

Albanian

Kur shërbimi A të rivendoset në Howard Beach dhe shërbimi me autobus t'a lidhë atë me Mott Avenue në Far Rockaway, klientët nga Gadishulli Rokauej do të kenë disa alternativa të udhëtimit.

- Nga Mott Avenue në Far Rockaway, linja e rregullt Q22 funksionon për në Roksbëri.
- Nga stacioni A në Rockaway Boulevard, shërbimi i rregullt i autobusit me ndalime të kufizuara Q53 funksionon për në Rockaway Park-Beach 116 Street, si dhe shërbimi Q52 për në Arverne-Beach 69 Street.
- Nga stacioni i Brooklyn College/Flatbush Avenue në tranin 2 dhe 5, shërbimi i rregullt Q35 funksionon për në Rockaway Park-Beach 116 Street.
- Nga stacioni Parsons-Archer në Xhamejka në trenat E, J dhe Z, shërbimi me ndalesa të rregullta dhe të kufizuara Q113 funksionon për në Mott Avenue në Far Rockaway, si dhe në Seagirt Boulevard.

Për informacion të azhornuar të udhëtimit me MTA, ju lutemi shkoni në mta.info dhe kërkoni azhornime special të Rokauej, përdorni TripPlanner+ në mta.info ose telefonojini 511.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418